



## ÇFARË JEMI DUKE BËRË

Projekti përfaqëson mbështetje plotësuese të Asistencës Teknike (AT) për KPRS-në me qëllim të ofrimit të mbështetjes së kapaciteteve gjithëpërfshirëse për ministrinë kryesore të linjës dhe palët e interesuara, si dhe ndërmarrjen e monitorimit dhe vlerësimit të vazhdueshëm dhe sistematik të procesit të reformës së sektorit.

Projekti duhet të ofrojë mbështetje për ministrinë kryesore në Sektorin e Arsimit, Punësimit dhe Politikës Sociale (EESP) për të organizuar angazhimin dhe pjesëmarrjen sistematike të komunave, partnerëve të biznesit dhe ato social si dhe organizatave të shoqërisë civile në procesin e reformës së sektorit në lidhje me aktivitetet e KPRS-ës dhe prioritetet e reformës sektoriale.

## PASQYRË E KRPS-ËS DHE AKTORËT KRYESOR

KPRS-ja e IPA II AD2019 është krijuar për të mbështetur zbatimin e kornizës strategjike në fushën e punësimit të rinjve dhe arsimit dhe aftësimin profesional nga institucionet në Republikën e Maqedonisë së Veriut. KPRS-ja është konceptuar si një nismë bashkëfinancuese krahas burimeve kombëtare të alokuara, duke optimizuar përplekjet dhe duke rritur shanset për përfundimin e suksesshëm të nismave të synuara të politikave. Një buxhet plotësues i Asistencës Teknike (AT) prej 1.5 milionë euro sigurohet nga BE-ja për të mbështetur autoritetet kombëtare, duke i ndihmuar ato të forcojnë kapacitetet e tyre për të zbatuar reformat sektoriale në lidhje me Mbështetjen Buxhetore të Sektorit/KPRS 'BE për të rinjtë', dhe duke i mbështetur ato në monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit dhe arritjes së treguesve të performancës të përcaktuara në bazë të KPRS-ës. Disa nga përfuturit kryesorë janë:

<b>MASH</b>	Sipas planit të zbatimit të GR, MASH-i është përgjegjëse për përshpejtimin e reformave arsimore të planifikuara tashmë në nivelin fillor, të mesëm dhe terciar
<b>MPPS</b>	MPPS është përgjegjëse për mekanizmat koordinues dhe monitorues që mbikëqyrin zbatimin e reformave
<b>Ministria e Financave (MeF)</b>	Përgjegjëse për ekzekutimin financiar të Programit të Veprimit IPA 2019 dhe KPRS. MeF është ministria udhëheqëse në ciklin e mbështetjes buxhetore për përgatitjen dhe paraqitjen e kërkesave vjetore për shpërndarjen e trashave të ndryshueshme
<b>ASHP</b>	Përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve të aktivizimit dhe masave integruese në tregun e punës për të rinjtë (15-29) të regjistruar në skemë.
<b>Qendra APT</b>	<b>Qendra e Arsimit Profesional dhe Trajnim (Qendra APT)</b> është organi kryesor publik përgjegjës për ofrimin e mbështetjes profesionale për zhvillimin dhe inovacionin e vazhdueshëm të sistemit të APT-së.
<b>Qendra për Arsimin e të Rriturve (QAR)</b>	Institucion publik që promovon një sistem funksional dhe modern të arsimit të të rriturve. QAR është i fokusuar në rritjen e punësimit dhe zhvillimin e sipërmarrjes, si dhe në plotësimin e nevojave të tregut të punës dhe kontributin drejt zhvillimit ekonomik, social dhe personal.
<b>Agjencia për Rini dhe Sport (ARS)</b>	<b>Agjencia për Rini dhe Sport (AYS)</b> është përgjegjëse për aktivitetet që kanë të bëjnë me të rinjtë në Maqedoni. Së bashku me përfaqësues të shoqatave koordinuese rinore, është përgjegjëse për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Rininë (2016-2025).

## Aktivitete

**Aktiviteti 1: Ndërtimi i kapaciteteve të autoriteteve kombëtare për hartimin, zbatimin, monitorimin dhe raportimin mbi reformat sektoriale bazuar në prova të forta dhe analiza gjinore.**

Ndër të tjera përfshihen masat e vlerësimit dhe ngritjes së kapaciteteve për përmirësimin e kapaciteteve aktuale të dy ministrive (MASH dhe MPPS) për të ndërtuar dhe zbatuar një politikë sektoriale të besueshme.

**Aktiviteti 2: Mbështetje për aplikimin sistematik të metodologjive të sistemit gjurmues për ofruesit e APT-së dhe Garancitë për Rininë dhe programet e gjenerimit të punësimit.**

Ky aktivitet përfshin mbështetjen për ministrinë dhe agjencitë kryesore për të hartuar dhe vendosur një metodologji për sistemet gjurmuese për APT-në fillestare dhe të vazhdueshme dhe Garancitë për Rininë, për të përfshirë një fazë fillestare pilotuese të një minimumi prej 10 shkollash të APT-së dhe 10 Qendrave të Arsimit për Rritur.

**Aktiviteti 3: Monitorimi dhe Vlerësimi i arritjeve të kushteve të përgjithshme dhe specifike sipas Kontratës së Performancës së Reformës Sektoriale.**

Me fjalë të tjera, aktiviteti përfshin monitorimin e rezultateve të arritura me qëllim të shpërndarjes së 15 milionë eurove të mbështetjes direkte buxhetore nga BE-ja për Maqedoninë e Veriut.

**Aktiviteti 4: Ngritja e ndërgjegjësimit të palëve të interesuara, medias dhe publikut të gjerë mbi arritjet e përmirësimit të shkallës së punësimit për të rinjtë.**

Ofrimi i ndihmës autoriteteve kombëtare për të ndërtuar një qasje të fortë komunikimi për informimin e grupeve të synuara dhe publikut të gjerë mbi mundësitë e ofruara nga Garancia për Rininë dhe programet e APT-së.



Shuma e alokuar për mbështetjen buxhetore/KPRS është 15 milionë euro, e cila synon të mbështesë financiarisht zbatimin e ESRP (2017-2020), kosto totale e së cilës është 434 milionë euro, e ndarë për tre akset: Tregu i Punës dhe Punësimi – 88 milionë euro; Kapitali Njerëzor dhe Aftësitë – 97 milionë euro; Përfshirja Sociale dhe Mbrojtja Sociale – 252 milionë euro.


## DISA ARRITJE NË KUSHTET E PËRGJITHSHME (GR DHE APT)

Maqedonia e Veriut është shteti i parë jo-anëtar i BE-së që ka krijuar skemë të Garancisë për Rininë për të adresuar punësimin dhe nën-punësimin që i imponohen shoqërisë.

Duke ndjekur modelin evropian, GR e Maqedonisë së Veriut ka për qëllim t'u ofrojë të rinjve që nuk janë në punësim, arsim ose trajnim (NEET) një ofertë punësimi, arsimimi dhe trajnimit të vazhdueshëm, ose një stazh trajnimit brenda katër muajve pasi të mbeten të papunë ose të largohen nga shkolla.

Koncepti i GR ishte prezantuar për herë të parë si pilot në tri komuna në vitin 2018. Në vitin 2019, GR u zbatua në të gjithë vendin, me fokus të veçantë në **tre rajone (Pollogu, Verilindor dhe Jugperëndimor, përfshirë Resnjën)**, në të cilat numri më i lartë i të rinjve të përcaktuar në kategorinë NEET. Në fazën e dytë (2020-2022), Garancia GR shtrihet në të gjithë vendin, duke synuar të gjithë të rinjtë NEET (15-29) që banojnë ligjërisht në Maqedoninë e Veriut – hyrja në skemën GR bëhet përmes regjistrimit në qendrat lokale të punësimi.

Pjesëmarrës të GR të punësuar sipas kombësisë (totali)




■ Maqedonas ■ Shqiptarë ■ Roma  
■ Turq ■ tjerë



Gjithsej, 25,502 të rinj (12,863 prej tyre vajza) u regjistruan në skemat GR në vitin 2020. Nga këta, 7,684 u punësuan brenda katër muajve dhe 1,257 të rinj morën disa nga masat aktive të punësimi që nuk çojnë në punësim, por rrisin punësueshmërinë e tyre. Prandaj, shkalla e kthimit nën GR është 35 përqind deri më këtë moment.

## ARSIMI PROFESIONAL DHE TRAJNIMI

Numri total i nxënësve në arsimin e mesëm profesional



Në vitin 2020 janë themeluar tri shkolla të mesme shtetërore Qendra Rajonale për Arsim Profesional: Shkolla e Mesme Profesionale "Mosa Pijade" – Tetovë (Rajoni i Pollogut); Shkolla e Mesme Profesionale Verilindore "Kiro Burnaz" – Kumanovë (Rajoni Verilindor); dhe Shkolla Komunale e Hotelierisë dhe Turizmit "Vanço Pitosevski" – Ohër (Rajoni Jug-Perëndimor). Tre Qendrat Rajonale të ATP-së (QRATP) janë krijuar për të ofruar arsim të cilësisë së lartë të ATP-së, për të përmirësuar risitë në procesin arsimor dhe për t'u mundësuar të rinjve të hyjnë në tregun e punës me kualifikimet përkatëse.

## Ndryshimet ligjore

### Strategjia Kombëtare

Në procesin e reformës arsimore parashikohen dy qëllime kryesore: 1) Cilësia dhe gjithëpërfshirja e arsimit dhe 2) Punësimi dhe ndërtimi i rrugëve të lehta të të mësuarit gjatë gjithë jetës.

**Ligji i ri për Arsimin Fillor.** Ligji i ri filloi të zbatohet nga viti akademik 2019/2020. Aktet nënligjore dhe konceptet që dalin nga ligji i ri janë duke u hartuar aktualisht. Merr parasysh nevojat e ndryshme individuale për zhvillim të nxënësve, duke siguruar mundësi të barabarta për ushtrimin e të drejtave themelore të njeriut për zhvillim dhe arsim cilësor.

**Ligji për Arsimin e Mesëm** është harmonizuar me dispozitat e planifikuara për përfshirje që dalin nga Ligji për Arsimin Fillor. Kjo siguron vazhdimësi në arsimin e nxënësve.

**Ligji për Arsimin e Mesëm Profesional** ishte përgatitur në TM4 2020 dhe aktualisht është i hapur për debat publik.

**Ligji i ri për Arsimin e të Rriturve.** Ligji i ri që mbulon arsimin e të rriturve është miratuar nga Qeveria në vitin 2020 dhe aktualisht kalon në Parlament.

**Ligji për Standardet Studentore** i referohet rolit të konvikteve studentore për studentët që mësojnë jashtë vendit të tyre të banimit. Ligji përcakton gjithashtu llojet e ndryshme të bursave që studentët mund të marrin në bazë të nevojave dhe prejardhjes socio-ekonomike, të gjitha me synimin e përfshirjes në arsim.

**Ligji për Mbrojtjen e Fëmijëve** përmban dispozita për kujdesin dhe edukimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara fizike dhe mendore; ligji parashikon të drejtën për një shtesë të veçantë për fëmijët me nevoja të veçanta, duke përfshirë aftësitë e kufizuara deri në moshën 26 vjeç.

**Ligji për Arsimin e Lartë** (miratuar në maj 2018) ka mundësuar një mjedis më të favorshëm për studentët me nevoja të veçanta.

**Ligji për Pjesëmarrjen Rinore dhe Politikën Rinore** është miratuar në vitin 2020. Ligji rregullon format e organizimit të të rinjve, pjesëmarrjen e të rinjve në procesin e krijimit të politikave rinore dhe proceset vendimmarrëse që ndërlidhen me ato.